



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 3343/1 Prot.

Vlorë më, 23.12.2025

VENDIM

Nr. 128 datë 23.12.2025

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRËTË TË STUDIMEVE, NË
FAKULTETIN E SHËNDETIT, DOKTORATË NË "SHKENCAT E SHËNDETIT"
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI",
VLORE**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja dh, nenit, 70, 77, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", e ndryshuar, VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; si dhe referuar propozimit Dekanit të Fakultetit të Shëndetit, përcjellë me shkresën 1808/1 prot., datë 19.12.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 23.12.2025,


VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Dekanit të Fakultetit të Shëndetit për hapjen e programit të ciklit të tretë të studimit Doktoraturë në "Shkencat e Shëndetit", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike dhe Fakulteti i Shëndetit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj



Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlori.edu.al
e-mail: info@univlori.edu.al